



Skenderbeu ka marre arratine pas fitores 2-0 me skuadren e Flamurtarit. Kampionet kane mposhtur vlonjatet ne nje stadium te boshatisur por edhe pa pranine e tifozeve ja kane dale te marrin tre piket. Nje gol i Arapit ne minuten e 32' ka zhbllokuar rezultatin e pas tij vlonjatet kane gelur me 10 lojtare per shkak te kartonit te kuq qe mori portiere Mocka.

Flamurtari ka provuar te bej rezistence por nuk ka mundur te lere shenje ne kete takim qe eshte vulosur perfundimisht nga nje gol i Pero Pejic ne minuten e 54'.

Ne Shkoder, Villaznia eshte thyer nga Kukesi. Ne pjesen e pare kane shenuar vendasit ndersa ne pjesen e dyte ka ardhur permbysja e madhe. Golin e Semines ne minuten e 35 e ka barazuar Shameti ne minuten e 53' dhe pas tij Popovic ka sjelle golin e fitores ne minuten e 75'. Villaznia ka provuar te barazoj por sja ka dale duke marre shume kritika nga tifozet e zhgenjyer ne Loro Borici.

Ne kryeqytet, Partizani ka bere nje super permbysje duke realizuar dy gola brenda dy minutave. Emiljano Veliaj kishte shenuar me pare ne minuten 68' me penallti dhe kur dukej se gjithcka po perfundonte ne favor te Lacist, Partizani ka bere permbysjen e madhe. Ne minuten e 89' ka shenuar Maliqi dhe dy minuta me pas ka shenuar golin e fitores Hyshmeri. Festa e tifozeve te kuq ka qene e ligjshme. Me keto tre pike tani Partizani e shikon veten ne vendin e dyte, i vetem per here te pare.